LIGJ
Nr.10 329, datë 30.9.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9669, DATË 18.12.2006 "PËR MASAT NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 6, pas shkronjës "g" shtohet shkronja "gj" me këtë përmbajtje:

"gj) ngritjen e një qendre kombëtare të shërbimit të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje.".

Neni 2

Në nenin 8, pas pikës 6 shtohen pikat 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

"7. Punonjësit e shërbimit e të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, pranë institucioneve publike dhe organizatave jofitimprurëse të licencuara, si dhe avokatët e përfaqësuesit ligjorë të viktimave të dhunës në familje ruajnë fshehtësinë e të dhënave personale dhe të informacioneve që viktima jep për situatën e saj, përveçse kur përcaktohet ndryshe me shkrim nga viktima.

8. Mekanizmi i bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe mënyra e procedimit të tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 3

Në nenin 9 pika 1, fjalët "postës së policisë" zëvendësohen me fjalët "stacionit të policisë".

Neni 4

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 shkronja "g", fjala "konfiskojnë" zëvendësohet me fjalën "sekuestrojnë".

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Në rastin e zbatimit të shkronjës "g", vendimi i gjykatës parashikon:

a) pezullimin e lejes së armës deri në plotësimin e afatit të urdhrit të mbrojtjes, si dhe njoftimin e autoritetit përkatës administrativ, nëse arma është sekuestruar dhe personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje;

b) kthimin e armës së sekuestruar, nëse personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje, vetëm pas mbarimit të afatit të përcaktuar në urdhrat e mbrojtjes.".

Neni 5

Në nenin 13 pika 2, pas shkronjës “d” shtohen shkronjat “dh” dhe “e” me këtë përmbajtje:

“dh) policia/prokuroria;

e) personat ligjërisht përgjegjës për fëmijët.”.

Neni 6

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

1. Në fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike u njoftojnë gjykatave listën e avokatëve, që autorizohen për dhënien e ndihmës juridike falas.”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Kërkuesi shkarkohet nga të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifat për shpenzimet gjyqësore, si dhe ato të shërbimeve përmbarimore shtetërore, sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi. Me lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje.”.

Neni 7

Në nenin 18, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme:

a) të një të mituri, brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës;

b) të subjekteve të tjera të dhunës në marrëdhëniet familjare, brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës.”.

Neni 8

Në nenin 19 pika 5, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) zyrave përmbarimore të vendit të ekzekutimit.”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6723, datë 12.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi